



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. .... Prot.

Vlorë, më 02.03.2018

**Vendim**  
**Nr. 5, datë 02.03.2018**

**PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PERSONELIT NDIHMËSAKADEMIK ME KARAKTER MËSIMOR, PERSONELIT NDIHMËSAKADEMIK ME KARAKTER ADMINISTRATIV DHE PERSONELIT ADMINISTRATIV NË UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI”, VLORË**

Bazuar në nenin 67/1 të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 187, datë 08.03.2017, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësimin e ministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, apa ratet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit (1)(2)”, Vendimit nr. 202, datë 15.03.2017, të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, të ndryshuar, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 02.03.2018,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë nivelet e pagave për personelin ndihmësakademik me karakter mësimor, personelit ndihmësakademik me karakter administrativ dhe personelit administrativ në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë sipas propozimit të Administratorit të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë me shkresën nr. 243 Prot, datë 19.02.2018.
2. Ngarkohet Administratori i Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, Drejtoria e Financës dhe Realizimit të Buxhetit si dhe Përgjegjësi i Sektorit të Administrimit të Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Dr. Rezana Vrapi – Kryetar

1. Ornela Koleka – anëtar
2. Florian Nurçe – anëtar
3. Dr. Enida Pulaj – anëtar
4. Dr. Marinela Muço – anëtar
5. Dr. Elsajed Rexhaj – anëtar